Arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit dhe ndikimi që ai do të ketë

Ky projektakt propozohet në mbështetje të dispozitave të Ligji Nr. 139/2015 dhe Ligji Nr. 146/2014, me qëllim:

- *përmirësimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve, në përputhje me kompetencat dhe funksionet e bashkisë të përcaktuara në Ligjin Nr. 139/2015;*
- *rritjen e eficiencës administrative, transparencës dhe llogaridhënies publike, bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr. 139/2015 dhe nenin 6 të Ligjit Nr. 146/2014;*
- *përmbushjen e detyrimeve ligjore për konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës, sipas nenit 18 të Ligjit Nr. 139/2015 dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 146/2014;*
- *adresimin e nevojave dhe interesave të komunitetit lokal përmes përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve publike.*

Ndikimi i pritshëm i projektaktit

Zbatimi i këtij projektakti pritet të sjellë:

- *rritje të cilësisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve publike për qytetarët;*
- *forcim të pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës në vendimmarrjen vendore, në përputhje me nenin 18 të Ligji Nr. 139/2015;*
- *përmirësim të menaxhimit institucional dhe administrimit financiar të bashkisë;*
- *ndikim pozitiv social, ekonomik dhe komunitar në funksion të zhvillimit vendor dhe interesit publik.*